



Datë: 10.03.2026
Numër Protokolli: 1267/2026

A.nr.224/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.224/2026, të datës 02.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.J, më objekt ankimor “*kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.224/2026, e datës 02.03.2026, e parashtruar nga ankuesi A.J.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.J (*tutje referuar ankuesi*), më datë 02.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025, me pretendimin se vlerësimi është jo i drejtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.03.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emailat lidhur me kundërshtimin e vlerësimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 18.02.2026 dhe provat tjera të bashkangjitura; ID identifikuese e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është e palejuar, sepse:

Gjendja e fakteve

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër 45032/24, të datës 10.09.2024, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë Ligjor* në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Vushtrrisë.
- Më datë 18.02.2026, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin sipas nivelit të përgjithshëm të vlerësimit *“arrin pritshmërinë”*

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi është i pa drejtë, jo real dhe jo në proporcion me angazhimin, përkushtimin dhe profesionalizimin. Kërkon së ankesa të rishqyrtohet në Këshill.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushemërisë së ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, me theks të veçantë nenit 52 me te cilin është përcaktuar se: *“...2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; **13.3. arrin pritshmëritë**; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme. 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 17. **Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”**.*

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe nenin 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, më të cilin nen përcaktohet: 1. *Nëpunësi civil i pakënaqur me vlerësimet “e papranueshme” dhe “ka nevojë për përmirësim” ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve.*

Andaj, në kuptim të kuadrit ligjor si me lart dhe duke qenë se ankuesi për vitin 2025 është vlerësuar më nivelin e përgjithshëm “*arrin pritshmërinë*”, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse, siç përcaktohet me dispozitat ligjore si me sipër e drejta e kundërshtimit më ankesë si mjet e rregullt juridik lejohet vetëm në rastet e vlerësimit më nivel “*ka nevojë për përmirësim*” dhe “*e papranueshme*”. Kështu që, mbi këto rrethana ankesa e ankuesit A.nr.224/2026 është e palejueshme në vështirim të dispozitave të nenit 52, paragrafi 17, ndërlidhur me nenin 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përshihet se : “1. *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji.*

Theksuar si me larte e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.224/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.J;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.